



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 39

Tiranë – E martë, 17 mars 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 12.3.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 3021
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 12.3.2020	Për përcaktimin si zonë të lirë të një pjese të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në Porto-Romano..... 3024
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 108, datë 28.2.2020	Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa llojeve kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera, në administrim të këtyre shteteve”, të miratuar me urdhrin nr. 328, datë 22.11.2011, të ministrit të Bujqësisë..... 3026
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 21.2.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 80% të kuotave të kapitalit.... 3039
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 21.2.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 3040
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 21.2.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 177, seria PV12K, për “Prodhimin e energjisë elektrike” nga HEC-et: “Cermenica 1”, “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”, me fuqi totale të instaluar 3,88 mw, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012..... 3041
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 21.2.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Kuçova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw..... 3043
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 21.2.2020	Mbi modifikimin e aneksit të licencës së shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., nr. 95, seria PV10K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për licencimin e shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k..... 3045

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 27.2.2020	Mbi vendimin e ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, “Mbi kërkesën për moslicencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”.....	3046
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 6.3.2020	Mbi miratimin e amendimit të kontratës me nr. KESH/nr. 6651 prot., dhe OST/nr. 8859 prot., datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”.....	3048
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 6.3.2020	Mbi miratimin e rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në Tregun e Bashkuar.....	3049
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 6.3.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”, me kapacitet të instaluar 1600 kw; HEC “Backa 2”, me kapacitet të instaluar 4000 kw; HEC “Backa A”, me kapacitet të instaluar 500 kw; HEC “Backa B”, me kapacitet të instaluar 500 kw; HEC “Backa C”, me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total të instaluar 7320 kw....	3051
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 42, datë 6.3.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Electral Batra HPP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Selita”, me kapacitet të instaluar 1798 kw; HEC “Frankthi”, 2129 kw dhe HEC “Batra”, 2411 kw, me kapacitet total të instaluar 6338 kw.....	3053
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 43, datë 6.3.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s.....	3055
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Aldo Çavolli.	3056
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dhimitër Malja.....	3056

**VENDIM****Nr. 216, datë 12.3.2020****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Neni 231/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 231/1

Kriteret dhe rregullat për kontrollin dhe për verifikimin e përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre, që prodhohen dhe importohen
(Neni 76 i Kodit Rrugor)

1. Shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre, që prodhohen dhe importohen në Republikën e Shqipërisë (që më poshtë do të quhet “Shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit”) do të kryhet pranë qendrave të kontrollit teknik, të licencuara nga ministri përgjegjës për transportin.

2. Subjekti, që do të kryejë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

2.1 të ketë përvojë të suksesshme mbi 3 (tre) vjet në realizimin e shërbimeve në fushën e mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre;

2.2 të ketë personel drejtues/menaxhues teknik me përvojë pune më shumë se 5 (pesë) vjet në realizimin e shërbimeve në fushën e mjeteve me

motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre, në mënyrë që të garantojë me kompetencë dhe me cilësi këtë shërbim;

2.3 të ketë staf të mjaftueshëm profesional teknik, i cili të ketë përvojë pune më shumë se 3 (tre) vjet në këtë fushë, në realizimin e shërbimeve në fushën e mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre, në mënyrë që të garantojë me kompetencë dhe me cilësi këtë shërbim;

2.4 të sigurojë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme sipas kërkesave të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit;

2.5 të zotërojë personalitet juridik dhe pas përzgjedhjes të sigurohen për përgjegjësinë në ushtrimin e veprimtarisë së këtij shërbimi;

2.6 të informojë rregullisht ministrinë përgjegjëse për transportin me anë të një raporti mujor me shkrim për gjendjen (funksionale, teknike, kapacitetin etj.) dhe sasinë e mjeteve rrugore që kanë kryer kontrollin dhe verifikimin.

3. Qendrat e shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre (që më poshtë do të quhet “Qendra e kontrollit dhe e verifikimit”) për kryerjen e shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit duhet:

3.1 të sigurojnë kushte të mjaftueshme materiale-teknike dhe kapacitete operationale, që të garantojnë funksionimin e përshtatshëm në ushtrimin e këtij shërbimi;

3.2 të kenë pajisje kompjuterike së bashku me *software*-ët aplikativë nga fusha përkatëse e homologimit të mjeteve rrugore për verifikimin e karakteristikave të mjeteve rrugore dhe verifikimin e kërkesave e parametrave teknikë të këtyre mjeteve;

3.3 të sigurojnë vazhdimisht paanshmëri profesionale në marrëdhëniet me grupet e interesit (personat fizikë apo juridikë), të cilët janë të varur në mënyrë direkte apo indirekte nga rezultati i kontrollit dhe i verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjetit rrugor për të cilin konstatohet përputhshmëria;

3.4 të kenë certifikatën për menaxhimin e cilësisë ISO 9001, SSH ISO 9001 ose SSH EN ISO 9001 dhe të sigurojnë zbatimin e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave personale;

3.5 të kenë një sistem unik dhe uniform të ofrimit të shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit



të mjeteve rrugore në të gjitha qendrat e kontrollit dhe të verifikimit;

3.6 të kenë kapacitetet e nevojshme për monitorimin e shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit të mjeteve rrugore në kohë reale, përmes sistemeve të teknologjisë së informacionit;

3.7 të kenë nën vëzhgim me sistemin elektronik të kamerave mjediset ku kryhet shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit të mjeteve rrugore;

3.8 të kenë në strukturën organike personel i cili duhet të jetë i trajnuar dhe i certifikuar, si dhe i njohur nga subjekti i ngarkuar me mbikëqyrjen e qendrave.

4. Shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre, që prodhohen dhe importohen në Republikën e Shqipërisë, përfshihet në kategorinë VII.3 të shtojcës së ligjit për licencat.

Kjo veprimtari licencohet nga ministri përgjegjës për transportin në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë si dhe dispozitat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

Çdo licencë e lëshuar nga ministri përgjegjës për transportin publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

4.1 Subjektet e licencuara për kryerjen e shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit të mjeteve rrugore mbikëqyren nga persona juridikë publikë apo privatë, të specializuar dhe të caktuar nga ministri përgjegjës për transportin, sipas legjislacionit në fuqi.

4.2 Mbikëqyrja e shërbimit të kontrollit teknik dhe e kontrollit dhe të verifikimit të mjeteve rrugore do të kryhen nga i njëjti person publik ose privat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit do të kryhet përpara veprimeve të regjistrimit të mjeteve me motor, rimorkiove dhe sistemeve të tyre, të reja dhe të përdorura, që prodhohen ose importohen në Republikën e Shqipërisë.

5.1 Shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit të mjeteve rrugore nuk do të aplikohet, për:

- a) mjetet rrugore të projektuara dhe të prodhuara për/dhe në emër të ushtrisë;
- b) mjetet rrugore të projektuara dhe të prodhuara për/dhe në emër të shërbimit zjarrfikës;
- c) mjetet rrugore të projektuara dhe të prodhuara për/dhe në emër të policisë;

ç) mjetet rrugore me destinacion të veçantë dhe të përjashtuara nga autoriteti kontraktues, ministria përgjegjëse për transportin.

5.2 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të prodhuara në seri në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë përpara kryerjes së regjistrimit të tyre.

5.3 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të prodhuara individualisht në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë përpara kryerjes së regjistrimit të tyre.

5.4 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të reja, të importuara në seri në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë, përpara kryerjes së veprimeve të regjistrimit të tyre.

5.5 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të reja, të importuara individualisht në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë përpara kryerjes së veprimeve të regjistrimit të tyre.

5.6 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të përdorura, të importuara në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë përpara kryerjes së veprimeve të regjistrimit të tyre.

5.7 Mjete të përdorura do të konsiderohen mjetet rrugore të cilat janë të regjistruara në shtete të tjera dhe që importohen në Republikën e Shqipërisë.

6. Kategoritë e mjeteve rrugore, që do të kryejnë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit përpara kryerjes së veprimeve të zhdoganimit ose të regjistrimit të tyre, janë:

6.1 ciklomotorët dhe motomjetet e kategorive L1, L2, L3, L4, L5, L6 dhe L7, të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Rrugor.

6.2 mjetet për transport njerëzish me të paktën 4 rrota të kategorive M1, M2 dhe M3, të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Rrugor.

6.3 mjetet për transport mallrash me të paktën 4 rrota të kategorive N1, N2 dhe N3, përcaktuar në nenin 47 të Kodit Rrugor.



6.4 rimorkiot edhe gjysmërimorkiot të kategorive O1, O2, O3 dhe O4, përcaktuar në nenin 47 të Kodit Rrugor.

7. Procedura për kryerjen e shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit të mjeteve rrugore nga subjekti i licencuar nga ministri përgjegjës për transportin është, si më poshtë vijon:

7.1 Personi i interesuar ose përfaqësuesi i prodhuesit të mjeteve bën kërkesën për kryerjen e procedurës së shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit, si dhe dërgon mjetin rrugor te subjekti i përzgjedhur për kryerjen e këtij shërbimi.

7.2 Kërkesës për zbatimin e procedurës së shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit të mjeteve rrugore të reja i bashkëlidhet një nga dokumentet e mëposhtme:

7.2.1 kopja e homologimit të tipit të mjetit nga prodhuesi;

7.2.2 të dhënat teknike për mjetin rrugor nga prodhuesi;

7.2.3 certifikata e përputhshmërisë së mjetit, rimorkios, pajisjeve dhe pjesëve të mjetit (certifikata e përputhshmërisë nga prodhuesi për mjetet e prodhuara në seri;

7.2.4 COC-ja apo lista e direktivave /rregulloreve ndërkombëtare që përmbush mjeti rrugor i prodhuar individualisht);

7.2.5 kopja e faturës së shitjes.

7.3 Kërkesës për zbatimin e procedurës së shërbimit të kontrollit dhe verifikimit të mjeteve rrugore të përdorura i bashkëlidhet një nga dokumentet e mëposhtme:

7.3.1 të dhënat teknike për mjetin rrugor nga prodhuesi;

7.3.2 certifikata e përputhshmërisë së mjetit nga prodhuesi;

7.3.3 leja e qarkullimit etj.;

7.3.4 kopja e faturës së shitjes.

8. Shërbimi i kontrollit dhe i verifikimit të mjeteve rrugore që importohen në Republikën e Shqipërisë ka të bëjë me zbatimin e procedurës së:

a) kontrollit identifikues të mjetit rrugor;

b) verifikimit me tipin e miratimit të mjeteve të reja apo të përdorura, pavarësisht nëse janë të riparuar apo të modifikuara etj.;

c) identifikimit dhe verifikimit të pjesëve, pajisjeve e sistemeve të tyre.

8.1 Të gjitha mjetet rrugore, që importohen në Republikën e Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat teknike që garantojnë siguri në qarkullim,

mbrojtje të shëndetit të njerëzve e të mjedisit, si dhe kërkesat e tjera të ndërlidhura me këto mjete, rimorkio apo sisteme të tyre.

8.2 Plotësimi i kërkesave teknike konsiderohet në harmoni të plotë kur, nga kontrolli dhe nga verifikimi identifikues në dokumentacionin e prejardhjes së mjetit dhe në mjet, është konstatuar se ekziston përputhshmëri me kërkesat e përcaktuara teknike, të cilat janë në përputhje me rregulloret përkatëse ndërkombëtare (Konventa e marsit 1958, e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara “Marrëveshja në lidhje me miratimin e rregullave teknike uniforme për mjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të përshtaten dhe/ose përdoren në mjetet me rrota dhe kushtet për njohjen e ndërsjellë të miratimeve të dhëna në bazë të këtyre rregullave”, datë 20, direktivat 2007/46/EC, 2002/24/EC dhe 2003/37/EV) dhe që përmbushen të gjitha kushtet e përcaktuara.

8.3 Kur plotësohen kushtet e përputhshmërisë me tipin e homologuar, qendra e kontrollit dhe të verifikimit lëshon vërtetimin e përputhshmërisë me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre (që më poshtë do të quhet vërtetimi i përputhshmërisë).

8.4 Qendra e kontrollit dhe e verifikimit nuk lëshon vërtetimin e përputhshmërisë së mjeteve rrugore kur nuk plotësohen kushtet e përputhshmërisë me tipin e homologuar.

8.5 Për të rregulluar ose për të plotësuar kushtet e përputhshmërisë me tipin e homologuar të mjeteve rrugore, subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues do të përcaktojë një periudhë kohore të arsyeshme, afat deri në 60 ditë, për të bërë përmirësimet e nevojshme nga personi i interesuar.

8.6 Kur dhe pas periudhës së lënë në dispozicion për të bërë përmirësimet e nevojshme rezulton se mjeti vijon të mos jetë në përputhje me tipin e homologuar, subjekti i përzgjedhur nuk lëshon vërtetimin e përputhshmërisë dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor që të mos lejohet të kryhen veprimet e regjistrimit për këto mjete rrugore.

8.7 Modeli i vërtetimit të përputhshmërisë me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe të sistemeve të tyre përgatitet nga subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues për mbikëqyrjen e qendrave të kontrollit dhe miratohet nga ministri përgjegjës për transportin.



9. Kundër refuzimit të lëshimit të vërtetimit të përputhshmërisë së mjetit rrugor, sipas pikës 8.4, të këtij neni, mund të bëhet ankimim sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative pranë ministrisë përgjegjëse për transportin. Për shqyrtimin e ankimit ndiqet procedura vijuese:

9.1 Ministri përgjegjës për transportin ngre Këshillin e Ekspertëve të mjeteve rrugore për shqyrtimin e ankimeve.

9.2 Këshilli i Ekspertëve përbëhet nga pesë anëtarë, të kualifikuar në fushën transportit. Kërkohej që anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të jenë inxhinierë të kualifikuar në fushën e transportit rrugor: një nga bota akademike e fushës përkatëse, një nga DPSHTRR-ja dhe dy nga ministria përgjegjëse për transportin dhe që mbulojnë fushën përkatëse dhe një nga subjekti që kryen mbikëqyrjen e qendrave të kontrollit dhe të verifikimit të mjeteve rrugore.

9.3 Këshilli i Ekspertëve shqyrton ankesat për refuzimin e lëshimit të vërtetimit të përputhshmërisë së mjetit rrugor sipas aktit nënligjor të ministrit përgjegjës për transportin, brenda afatit kohor prej 15 ditësh nga data e pranimit të ankesës.

9.4 Këshilli i Ekspertëve, pasi shqyrton ankesën dhe kërkesat e palëve, jep rekomandime dhe ide konstruktive teknike për gjetjen e zgjidhjes, për të kryer ndryshimet e nevojshme në funksion të përputhshmërisë me kriteret e kërkuara për mjetet rrugore.

10. Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të cilat prodhohen ose importohen në Republikën e Shqipërisë, duhet të jenë të pajisura me vërtetimin e përputhshmërisë me tipin e homologuar nga qendrat e kontrollit dhe të verifikimit, të përzgjedhur nga autoriteti kontraktues, në mënyrë që të mund të regjistrohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

2. Pas pikës 11, të nenit 234, shtohet pika 12, me këtë përmbajtje:

“12. Veprimtaria e qendrave të kontrollit teknik të reja përfshihet në kategorinë VII.3 të shtojcës së ligjit për licencat.

Kjo veprimtari licencohet nga ministri përgjegjës për transportin në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, dispozitat dhe kriteret e përcaktuara në

këtë vendim si dhe kriteret e përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin.

Çdo licencë e lëshuar nga ministri përgjegjës për transportin publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 218, datë 12.3.2020

**PËR PËRCAKTIMIN SI ZONË TË LIRË
TË NJË PJESE TË TERRITORIT
DOGANOR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PORTO-ROMANO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 216, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin si zonë të lirë të një pjese të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në Porto-Romano.

2. Planvendosja e zonës së lirë dhe pikat e hyrjes e të daljes përcaktohen në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.


3. Ushtrimi i veprimtarisë në zonën e lirë do të autorizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pas plotësimit nga aplikuesi të kushteve dhe të kriterëve të parashikuara në kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë qëllim.

4. Të gjitha shpenzimet për rrethimin e zonës së lirë, plotësimin e kushteve të punës dhe për sistemet e monitorimit me videokamera e të ndriçimit, për ushtrimin e mbikëqyrjes nga autoritetet doganore, të përcaktuara në legjislacion, do të kryhen me shpenzimet e aplikuesit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**URDHËR****Nr. 108, datë 28.2.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “MBI PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR
CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA
LLOJEVE KAFSHËSH DHE MISHIT TË
FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA
SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA
TERRITORE TË TJERA, NË
ADMINISTRIM TË KËTYRE
SHTETEVE”, TË MIRATUAR ME
URDHRIN NR. 328, DATË 22.11.2011, TË
MINISTRIT TË BUJQËSISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, në nenin 42 dhe në nenin 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Certifikata, modeli BOV-X dhe BOV-Y, sipas pjesës së 2-të të urdhrit nr. 328, datë 22.11.2011, për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa llojeve kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera, në administrim të këtyre shteteve”, ndryshohet sipas modelit të certifikatave bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**



Modeli BOV-X

*Health certificate for import in the Republic of Albania
of bovine animals for breeding and / or production
Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë
të kafshëve të llojit gjedh për mbarështim dhe/ose prodhim*

Part I : Details of consignment / Pjesa I : Detajet e dorëzimit	I.1. Consignor Dërguesi		I.2. Certificate reference number Numri i referencës së Certifikatës		I.2a.			
	Name Emri		I.3. Central Competent Authority Autoriteti Kompetent Qëndror					
	Address Adresa							
	Tel. No Nr. Tel.							
	I.5. Consignee Marrësi		I.6.					
	Name Emri							
	Address Adresa							
	Postal code Kodi postar							
	Tel. No Nr. Tel.							
	I.7. Country of origin Shteti i origjinës		ISO code /kodi	I.8. Region of origin, Code Rajoni i origjinës, Kodi		I.9. Country of destination Shteti i destinacionit	ISO code ISO kod	I.10. Region of destination Rajoni i destinacionit
I.11. Place of origin/ Vendi i origjinës		Approval number Numri i Arovimit		I.12.				
Name Emri								
Address Adresa								
Name Emri		Approval number Numri i Arovimit						
Address Adresa								
Name Emri		Approval number Numri i Arovimit						
Address Adresa				I.14. Date of departure Data e nisjes			time of departure koha e nisjes	
Place of loading Vendi i ngarkesës		Approval number Numri i Arovimit						
Address Adresa								
I.15. Means of transport Mjeti i transportit		Aeroplane Aeroplan ☐		Ship Anije ☐		Railway wagon Hekurudhë ☐		
Road vehicle Automjet ☐		Other Tjetër ☐		I.16. Entry BIP in Albania PKK e hyrjes në Shqipëri				
Identification : Identifikimi		Documentary reference : Dokument i referimit		I.17.				
I.18. Description of commodity Përshkrimi i mallit/artikullit		I.19. Commodity code (HS code) Kodi i mallit/artikullit (kodi HS)		I.20. Quantity Sasia				
I.21.				I.22. Number of packages Numri i pakove				
I.23. Identification of container/Seal number Identifikimi i kontenierit /numri i vulës				I.24.				
I.25. Commodity certified as : Mall i çertifikuar si:		Breeding ☐ Për mbarështim		Fattening ☐ Majmëri				
I.26.		I.27. For import or admission into Albania Për import apo dërgim në Shqipëri						
I.28. Identification of the commodity Identifikimi i mallit		Species (scientific name) Speciet (emri shkencor)		Breed Raca		Identification system Sistemi i identifikimit		
		Identification number Numri identifikimit		Age Moshë		Sex Seksi		



Modeli BOV-X

Health certificate for import in the Republic of Albania
of bovine animals for breeding and / or production
Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë
të kafshëve të llojit gjedh për mbarëshitim dhe/ose prodhim

II. Health information Informacion shëndetësor	II.a. Certificate reference number Certifikatë me numër reference	II.b.
II.1. Public Health attestation Vërtetim për shëndetin publik I, the undersigned official veterinarian, hereby certify, that the animals described in this certificate: Une i nënshtuar Veterineri Zyrtar, certifikoj që kafshët e përshkruara në këtë certifikatë: II.1.1 come from holdings which have been free from any official prohibition on health grounds, for the past 42 days in the case of brucellosis, for the past 30 days in the case of anthrax and for the past six months in the case of rabies, and, have not been in contact with animals from holdings which did not satisfy these conditions: Vijnë nga ferma që kanë qënë jashtë çdo bllokimi zyrtar për motive shëndetësore në 42 ditët e fundit për brucelozën, në 30 ditët e fundit për plasjen dhe 6 muajt e fundit për tërbimin, dhe nuk kanë qënë në kontakt me kafshë të fermave të tjera që nuk kanë po të njëjtat kushte II.1.2. have not received: Nuk kanë marrë: – any stilbene or thyrostatic substances, Ndonjë stilbene apo substanca tireostatike, – oestrogenic, androgenic, gestagenic or β- agonist substances for purposes other than therapeutic or zoo-technic treatment (as defined in Council Directive 96/22/EC); Estrogjene, androgjene, gestagjene ose substanca β-agoniste për qëllime të ndryshme nga ato terapeutike apo trajtime zooteknike (përcaktuar në Direktivën e Keshillit 96/22/EC) II.1.3. with regard to bovine spongiform encephalopathy (BSE): Përsa i përket encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE): [(a) the animals are identified by a permanent identification system enabling them to be traced back to the dam and herd of origin and they have not been exposed to the following animals: [(a) kafshët janë identifikuar nga një sistem i përhershëm identifikimi që i lejon ata për të gjurmuar nga ferma apo tufa e origjinës nga kanë ardhur, dhe nuk janë ekspozuar nga kafshët e mëposhtme: i. any BSE cases, të prekura me BSE ii. bovine animals which, during their first year of life, were reared with the BSE cases during their first year of life, and which investigation has shown consumed the same potentially contaminated feed during that period, or kafshët e llojit gjedh të cilat, gjatë vitit të parë të jetës kanë pasur kontakt me raste BSE gjatë vitit të parë të jetës së tyre, dhe në të cilën investigimi ka treguar që është konsumuar potencialisht i njëjti ushqim i kontaminuar përgjatë asaj periudhe. iii. if the results of the investigation referred to in indent (ii) are inconclusive, bovine animals born in the same herd as, and within 12 months of birth of, BSE cases; nëse rezultatet e investigimit të përmendura në pikën (ii) janë inkonkluzive, kafshët e llojit gjedh kanë lindur në të njëjtën tufë, brenda 12 muajve nga lindja e tyre me raste me BSE (¹)(²)either [(b) if there have been BSE indigenous cases in the country concerned, the animals were born after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat – and –bone meal and greaves derived from ruminants, as defined in the Terrestrial Animal Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced or after the date of birth of the last BSE indigenous case if born after the date of feed ban.] (¹)(²) edhe [(b) nëse ka pasur raste indigjene të BSE në shtetin në fjalë, kafshët e lindura pas datës nga e cila është ndaluar ushqimi i ripërtypësve me miell mishi dhe kockash që derivojnë nga ripërtypësit, siç përcaktohet në Kodin Tokësor të Kafshëve e Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, është zbatuar në mënyrë efektive pas datës së lindjes së fundit të rastit indigjen të BSE ose nëse ka lindur pas datës së ndalimit të ushqimit. (¹)(³)either [(b) the animals were born after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-and-bone meal and greaves derived from ruminants as defined in the Terrestrial Animal Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced or after the date of birth of the last BSE indigenous case if born after the date of feed ban.] (¹)(³) edhe [(b) kafshët kanë lindur pas datës nga e cila ndalimi i ushqimit që vjen nga ruminantët me miell mishi dhe kockash siç përcaktohet në Kodin Tokësor të Kafshëve të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, është zbatuar në mënyrë efektive pas datës së lindjes së rastit të fundit indigjen të BSE, ose nëse ka lindur pas datës së ndalimit të ushqimit (¹)(⁴)either [(b) the animals were born at least two years after the date from which the ban on the feeding of ruminants with meat-and-bone meal and greaves derived from ruminants, as defined in the Terrestrial Animal Code of the World Organisation for Animal Health, was effectively enforced or after the date of birth of the last BSE indigenous case if born after the date of feed ban.] (¹)(⁴) edhe [(b) kafshët kanë lindur të paktën dy vjet pas datës nga e cila ndalimi i ushqimit të ripërtypësve me miell mishi ose kockash që derivojnë nga ripërtypësit, siç përcaktohet në Kodin Tokësor të Kafshëve, të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, është zbatuar në mënyrë efektive pas datës së lindjes së rastit të fundit indigjen të BSE ose në rast se ka lindur pas datës së ndalimit të ushqimit.		

Part II : Certification / Pjesa II : Çertifikata



Modeli BOV-x

Health certificate for import in the Republic of Albania
of bovine animals for breeding and/or production
Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë
të kafshëve të llojit gjedh për mbarëshitim dhe/ose prodhim

II.2. Animal Health attestation:

Vërtetim për shëndetin e kafshëve

I, the undersigned official veterinarian, hereby certify, that the animals described above meet the following requirements:
Une i nënshtkruari Veterineri Zyrtar, çertifikoj që kafshët e përshkruara plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

II.2.1. they come from the territory with code: (¹) which, at the date of issuing this certificate :
vijne nga teritore me kodin : (¹) që në datën e lëshimit të kësaj çertifikate:

(¹) either [(a) has been free for 24 months from foot-and-mouth disease,]
ose ka qënë e lire për 24 muaj nga sëmundja e aftës epizotike]

(¹) or [(a) has been considered free from foot-and-mouth disease since (dd/mm/yyyy), without having had
cases/outbreaks after that date, and authorised to export these animals by Commission Regulation (EU) No of (dd/mm/yyyy).]

(¹) or [(a) është konsideruar e lire nga sëmundja e aftës epizotike që nga (dd/mm/vvvv), dhe nuk ka pasur raste/vatra pas kësaj
date, dhe është autorizuar për eksportin e këtyre kafshëve nga Rregullorja e Komisionit (EU) Nr dt. (dd/mm/vvvv).]

(b) has been free for 12 months from rinderpest, Rift valley fever, contagious bovine pleuropneumonia and lumpy skin disease for 6
months from vesicular stomatitis,
ka qënë e lire për 12 muaj nga murtaja e gjedhit, ethja luginës Rift, pleuropneumonia infektive e gjedhit dhe dermatoza nodulare e gjedhi dhe
për 6 muaj nga stomatiti vezikular

(c) where during the last 12 months, no vaccination against these diseases mentioned in points (a),(b) and epizootic haemorrhagic disease
has been carried out and imports of domestic cloven-hoofed animals vaccinated against these diseases are not permitted,]

ku gjatë 12 muajve të fundit, nuk janë kryer vaksinime kundër këtyre sëmundjeve të përmendura në pikat (a), (b) dhe është kryer vaksinimi kundër sëmundjes
së ethes katarrale, importi i kafshëve dythundrake të vaksinuar kundër këtyre sëmundjeve nuk është lejuar.]

(¹) either [(d) has been free for 24 months from bluetongue and 12 months for epizootic haemorrhagic disease

(¹) edhe [(d) kanë qënë të lirë për 24 muaj nga sëmundja e gjuhës blu dhe 12 muaj për sëmundjen e ethes katarrale.

(1) (²) or [(d) has been free for 24 months from bluetongue, and the animals have reacted negatively to a serological test for the detection of
antibody for bluetongue and epizootic haemorrhagic disease, carried out on two occasions on samples of blood taken at the beginning
of the isolation/quarantine period and at least 28 days later, on (dd/mm/yyyy) and on
..... (dd/mm/yyyy), the second of which must have been taken within 10 days before export;]

(1) (³) or [(d) kanë qënë të lirë për 24 muaj nga sëmundja e gjuhës blu, dhe kafshët kanë reaguar negativisht ndaj një testi serologjik për
dedektimin e antitropave për sëmundjen e gjuhës blu dhe sëmundjes së ethes katarrale, të marra dy herë mostra gjaku në fillim të periudhës së
izolimit/karantinës dhe për të paktën 28 ditë më vonë, më (dd/mm/vvvv) dhe më (dd/mm/vvvv), e
dyta duhet kryer brenda 10 ditëve para eksportit;]

(¹) or [(d) has been free for 12 months from epizootic haemorrhagic disease and has not been free for 24 months from bluetongue, and the
animals have been vaccinated with an inactivated vaccine, at least 60 days before the date of dispatch to the Union, against all bluetongue
serotype/s (insert serotype) which are those present in the source population as demonstrated through a surveillance programme (12) in an
area with a 150 km radius around the holding(s) of origin described under box reference 1.11, and the animals are still within the immunity
period of time guaranteed in the specifications of the vaccine;]

(¹) ose [(d) kanë qënë të lirë për 12 muaj nga sëmundja e ethes katarrale dhe nuk kanë qënë të lirë për 24 muaj nga gjuha blu, dhe kafshët janë
vaksinuar me një vaksinë joaktive, të paktën 60 ditë para datës së dërgimit në Republikën e Shqipërisë, kundër të gjithë serotipeve të gjuhës
blu (vendosni serotipin) që janë të pranishme në popullatën e burimit si të demonstruar përmes një programi survejance (12) në një zonë
me një rreze prej 150 km rreth stabilimentin e origjinës së përshkruar në kutinë e referencës 1.11, dhe kafshët janë akoma brenda periudhës kohore të
imunitetit të garantuar në specifikimet e vaksinës;]

(¹) (¹³) or [(d) is seasonally free of bluetongue and epizootic haemorrhagic disease and the animals have been kept during the seasonally free
period in the seasonally free territory since birth or for at least 60 days prior to shipment;]

(¹) (¹³) ose [(d) janë sezonalisht të lirë nga sëmundja e gjuhës blu dhe ethes katarrale dhe kafshët janë mbajtur gjatë periudhës sezonale të lirë në një
territor sezonalisht të lirë duke nisur nga lindja për të paktën 60 ditë para dërgesës

(¹) (¹³) or [(d) is seasonally free of bluetongue and epizootic haemorrhagic disease and the animals have been kept during the seasonally free
period in the seasonally free territory for at least 28 days prior to shipment, and have reacted negatively to a serological test according to the OIE
Manual for detection of antibodies for bluetongue and epizootic haemorrhagic disease, carried out at least 28 days after the start of the residence
period;]

(¹) (¹³) ose [(d) është sezonalisht e lirë nga sëmundja e gjuhës blu dhe ethes katarrale dhe kafshët janë mbajtur gjatë periudhës së lirë sezonale në një
territor të lirë sezonal për të paktën 28 ditë para dërgesës, dhe kanë reaguar negativisht nga një test serologjik bazuar në manualin e OIE për zbulimin të
antitropave për sëmundjen e gjuhës blu dhe ethes katarrale, të kryer të paktën 28 ditë pas fillimit të periudhës së qëndrimit;]

(¹³) or [(d) is seasonally free of bluetongue and epizootic haemorrhagic disease and the animals have been kept during the seasonally free period
in the seasonally free territory for at least 14 days prior to shipment, and have reacted negatively to a PCR test for bluetongue virus and
epizootic haemorrhagic disease virus according to the OIE Manual, carried out at least 14 days after the start of the residence period;]

(¹³) ose [(d) janë sezonalisht të lirë nga sëmundja e gjuhës blu dhe ethes katarrale dhe kafshët janë mbajtur gjatë periudhës së lirë sezonale në një



Modeli BOV-X

*Health certificate for import in the Republic of Albania
of bovine animals for breeding and / or production
Çertifikata shëndetësore për importin në Republikën e Shqipërisë
të kafshëve të llojit gjedh për mbarëshitim dhe/ose prodhim*

- an individual number which permits tracing of their premises of origin. Specify the identification system (such as tag, tattoos, brand, chip, transponder) - nje numer identifikimi personal, qe lejon te gjurmohet vend-origjina e tyre. Specifikoni sistemin e identifikimit (te tille si etikete, tatuazh, markim, çip, transponder) - an ear tag that includes the ISO code of the exporting country. The individual number must permit tracing of their premises of origin. Nje etikete ne vesh qe perfshin kodin ISO te vendit eksportues. Numri i individit duhet te lejojne gjetjen e lokaleve te tyre te origjinës. - Species, Select amongst "Bos", "Bison" and "Bubalus" as appropriate. <i>Speciet, Zgjidh ndermjet "Bos", "Bison" dhe "Bual" sipas perkatesise.</i> - Age: Date of birth (dd/mm/yy) <i>Mosha: Data e lindjes (date/muaj/vit)</i> - Sex: (M = male, F = female, C = castrated) <i>Seksi: (M= mashkull, F= femer, C= kastruar).</i>	
Part II: Pjesa II:	
(¹) Keep as appropriate. Mbajini si duhet (²) Only if the animals were born and continuously reared in a country or region or countries or regions classified in accordance with Decision 2007/453/EC as a countries or regions posing a negligible BSE risk Vetëm nëse kafshët janë lindur dhe rritur në vazhdimësi në një vend apo rajon i kategorizuar në përputhje me vendimin nr. 2007/453/ EU si territor ose rajon që paraqet një rrezik të papërfillshëm të BSE (³) Only if the country or region of origin is classified in accordance with Decision 2007/453/EC as a country or region posing a controlled BSE risk. Vetëm nëse vendi apo rajon i origjinës është kategorizuar në përputhje me vendimin nr. 2007/453/ EU si territor ose rajon që paraqet një rrezik të kontrollueshem të BSE. (⁴) Only if the country or region of origin is classified in accordance with Decision 2007/453/EC as a country or region with undetermined BSE risk. Vetëm nëse vendi apo rajon i origjinës është kategorizuar në përputhje me vendimin nr. 2007/453/ EU si territor ose rajon që paraqet një rrezik të papërcaktuar të BSE. (⁵) Code of the territory as it appears in Part 1 of Annex I to Regulation (EC) No 206/2010. Kodi i territorit të siç paraqitet në Pjesën I të Aneksit I të Rregullores (KE) Nr 206/2010 (⁶) Officially tuberculosis/brucellosis free regions and herds as laid down in Annex A to Council Directive 64/432/EEC; Zyrtarisht rajone dhe tufa të lira për Tuberkuloz/Brucelozë dhenë në Aneksin A të Direktivës së Këshillit 64/432/EEC; (^{6a}) Only for a territory appearing with entry "XII" in column 6 of Part 1 of Annex I to Regulation (EU) No 206/2010 indicating that bovine herds officially declared tuberculosis-free are recognised on equivalent conditions to those laid down in paragraphs 1 and 2 of Annex I to Directive 64/432/EEC for the purposes of importation of live animals certified according to the model of veterinary certificate BOV-Y Vetëm për një territor që paraqitet në hyrjen "XII" në kolonën 6 të Pjesës 1 të Shtojcës I të Rregullores (BE) Nr 206/2010 që tregon se tufat e gjedhit të deklaruara zyrtarisht të lira nga tuberkulozi, njihen me kushte ekuivalente me ato të përcaktuara në paragrafet 1 dhe 2 të Shtojcës I të Direktivës 64/432 / EEC për qëllimet e tregëtimit në Shqipëri e kafshëve të gjalla të certifikuar sipas modelit të certifikatës veterinarë BOV-Y (⁷) This mark shall take the form of "L" having 13 cm in the left side and 7 cm in the bottom side with 1 cm of strength in both lines. It shall be applied using the technique known as 'freeze-branding'. Kjo shenjë do të marrë formën e "L" duke patur 13 cm në anën e majtë dhe 7 cm në pjesën e poshtme me 1 cm ndërmjet dy linjave. Kjo do të aplikohet nëpërmjet përdorimit të teknikës së njohur si 'freeze-branding' (⁸) Date of loading. Imports of these animals shall not be allowed when the animals were loaded either prior to the date of authorization for exportation to the Albania of the territory referred in Box L.7 and L.8., or during a period where restrictive measures have been adopted by the Albania against imports of these animals from this territory. Data e ngarkimit. Importimi i këtyre kafshëve nuk lejohet kur kafshët ngarkohen ose para datës së autorizimit për eksportim të Shqipërisë për territoret e referuar në Kutinë L.7 dhe Kutinë L.8, ose gjatë një periudhe kur masat kufizuese janë përshtatur nga Shqipëria kundër importit të këtyre kafshëve nga ky territor. (9) Surveillance programme as laid down in annex I to Commission Regulation (EC) No 1266/2007 (OJ L 283, 27.10.2007, P37) Programi i survejancës siç përcaktohet në aneksin I të Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 1266/2007 (OJ L 283, 27.10.2007, P37)	
Official veterinarian Veterineri zyrtar Name (in Capital letters): Emri (me gërma kapitale) Date: Data Stamp Vula	Qualification and title: Kualifikimi dhe titulli Signature: Firma :



VENDIM
Nr. 30, datë 21.2.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“KASTRATI ENERGY” SHPK, PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA
E ERE-s PËR SHITJEN E 80% TË
KUOTAVE TË KAPITALIT

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pikës 5.2 të “Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”; të pikës 9.2, të “Licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.2.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 28/6 prot., datë 6.2.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., për dhënie e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., regjistruar në QKB, me NUIS L91325503D, është mbajtëse e licencës nr. 438, seria T19, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 38, datë 7.3.2019, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, si dhe e licencës nr. 439, seria F19, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 7.3.2019, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

- Në zbatim të pikës 3.6.4 të licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike dhe të pikës 4.4 të licencës për Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, i licencuari ka njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve, për ndryshimet si më poshtë:

- Është ndryshuar administratori i shoqërisë.

- Është ndryshuar emri i shoqërisë nga “Kastrati Energy” sh.p.k., në “EZ-5 Energy” sh.p.k.

- Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese, shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, e përbërë

nga 1 kuotë, që zotërohen nga ortaku “Kastrati Construction” sh.p.k.

- Në mbështetje të kërkesës për autorizimin nga ana e ERE-s, shoqëria ka depozituar:

- Vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, datë 21.1.2020, i cili parashikon hyrjen në fuqi pas miratimit nga ERE.

- Kontratë shitjeje kuotash dhe kapitalesh, nr. 230 rep., nr. 124 kol., datë 21.1.2020.

- Ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e shoqërisë.

- Vërtetimin nr. T01765847, datë 28.1.2020, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës se Administratori i shoqërisë nuk ndodhet në proces penal.

- Kërkesa e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k. është mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe nga shqyrtimi i saj, si dhe në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria në ERE, rezulton se ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore si i licencuar në aktivitetet e tregtimit dhe furnizimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k. për shitjen e 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë të zotëruara nga shoqëria “Kastrati Construction” sh.p.k., sipas kërkesës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 31, datë 21.2.2020****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA
ENERGY TRADE” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 21.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, me nr. 30/1 prot., datë, 7.2.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., me shkresën nr. 24/20 prot., datë 28.1.2020, protokolluar në ERE me nr. 246 prot, datë 28.1.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 263, seria FK15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 8, datë 2.2.2015, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, deri më 11.2.2020.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 27.9.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: Kryerja e aktivitetit të furnizimit dhe tregtimit në energji dhe mallra tregtare, si dhe aktivitete të tjera që lidhen me tregtimin e certifikatave të gjelbra dhe të gazit etj.

- Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b” dhe “c”): plotësuar.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”): plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”): plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gerrat “a”, “b”, “c”, “e”, “d”, “f”): plotësuar pjesërisht.

- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7, gerrat “b”, “c”): plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me azhurnimin e dokumentacionit apo plotësimit të saktë të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 1, germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit). Shoqëria duhet të paraqesë bashkëlidhur autorizimin për të deleguarin përgjegjës/përfaqësuesin ligjor.

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (Vërtetimin e Gjykatës dhe Prokurorisë për shoqërinë dhe administratorin e saj) do t’i kërkohej shoqërisë që të depozitojë në ERE, vërtetime të Prokurorisë dhe Gjykatës përkatësisht për administratorët, shoqërinë dhe përfaqësuesin ligjor.

- Nenin 9, pika 3, germa “d” (Vërtetim për kryerjen e pagesës së regjistrimit për aplikim): detyrimi është shlyer pjesërisht.

- Nenin 9, pika 4.7, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “h”, “i”: plotësuar pjesërisht. Do t’i kërkohej shoqërisë që këtë informacion /dokumentacion ta sjellë dhe në versionin *hard copy*, origjinal ose të njëzuar me origjinalin, sipas kërkesave të nenit 8, pika 3, të rregullores.

Germa “e” (Sistemin IT): pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur ndonjë informacion



/dokumentacion nëse është i certifikuar, nëse ka ndonjë kontratë ose marrëveshje për këtë kusht të rregullores etj.

Germa “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve). Shoqëria nuk ka paraqitur në ERE dokumentacion provues.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë, t’i plotësojë apo t’i saktësojë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 32, datë 21.2.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “REJ ENERGY” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 177, SERIA PV12K, PËR “PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” NGA HEC-et: “CERMENICA 1”, “CERMENICA 2” DHE “CERMENICA 3”, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 3,88 mw, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 120, DATË 29.8.2012

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, dhe 43 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, me nr. 30/2 prot., datë 7.2.2020, Mbi kërkesën e shoqërisë Rej Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 177, seria PV12K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012, për licencimin e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Cermenica 1”, “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 29, datë 30.1.2018, Bordi i ERE-s filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 177, seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 115/2 prot., datë 2.2.2018, ka përcjellë pranë subjektit kërkesën për plotësim dokumentacioni, e cila konsistonte në Miratimin e Autoritetit Kontraktues të projektit për modifikimin e licencës për rritjen e fuqisë së



instaluar të HEC-eve: “Cermenica 1”, “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”.

- Në vijim, shoqëria “Rej Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 115/8, datë 29.3.2018, ka përcjellë kërkesën për shtyrje të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s, duke bërë me dije se është në fazën e përgatitjes dhe dorëzimit të dokumentacionit në institucionet përgjegjëse, duke kërkuar shtyrje të afatit të vendimarrjes përfundimtare.

- Në mbledhjen e datës 6.4.2018, Bordi i ERE-s e pranoi këtë kërkesë, duke e shtyrë afatin e vendimarrjes finale.

- Shoqëria “Rej Energy” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1 të kontratës koncesionare, nr. 2519 rep., 288 kol, datë 14.7.2009, datë 14.7.2009, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., me cilësinë e Koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, “Për ndërtimin e hidrocentraleve: “Cermenica 1”, “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”, në zbatim të VKM-së nr. 194, datë 19.2.2009, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin sipas informacionit të subjektit, gjatë fazës së ndërtimit të HEC-eve Cermenica 1, 2, 3.

- Me shkresën nr. 6 prot., datë 30.1.2018, shoqëria “Rej Energy” sh.p.k. i është drejtuar Autoritetit Kontraktues (MIE), duke i bërë me dije, se parametrat hidroenergjetikë janë përmirësuar si rezultat i optimizimit të pellgut ujëmbledhës të përroit të Cermenicës, ku fuqia e instaluar arrin në 14980 kw.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 1944/1 prot., datë 23.2.2018, dërguar shoqërisë dhe për dijeni ERE-s dhe AKBN-së, ndër të tjera shprehet, se: “Institucionet e specializuara, në të gjitha rastet duhet të informohen dhe të bëjnë vlerësimin teknik të skemës hidroenergjetike të përmirësuar”.

- ERE, me shkresën e saj nr. 115/7 prot, datë 8.3.2018, ka bërë me dije shoqërinë, se shkresa e MIE-s nr. 124/1 prot., datë 18.10.2013, drejtuar ERE-s, referon: “Në rastin kur kërkesa për rritjen e fuqisë së instaluar, vjen si shkak dhe përputhet me fuqinë e instaluar të miratuar nga autoriteti kontraktues, në projektin e zbatimit, atëherë nuk ka nevojë për miratimin paraprak nga autoriteti kontraktues, ndërsa për të gjitha rastet e tjera duhet

të merret miratimi paraprak nga autoriteti kontraktues”.

- Gjithashtu, ERE, ka dërguar edhe dy shkresa pranë MIE-s (shkresa me nr. 371 prot., datë 27.5.2019 dhe shkresa me nr. 371/1 prot., datë 25.11.2019), “Kërkesë për informacion”, në lidhje me marrëveshjet e koncesionit dhe ato jokoncesionare që MIE, në rolin e Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar me shoqëritë, të cilat mund të konsistojnë në ndryshimin e kapacitetit të instaluar, afatin e ndërtimit dhe ndryshimin e aksionarëve etj., por për të cilat nuk ka marrë ende asnjë përgjigje nga MIE.

- Aplikimi i shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “c”: Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjerë të licencës, kur këta janë të kushtëzuar me miratimin nga organe të tjera: pa plotësuar. Pas përfundimit të afatit të kërkesës për plotësim dokumentacioni dhe pas një korrespondence të gjatë, nga ana e subjektit nuk është depozituar miratimi i modifikimit të projektit të rritjes së fuqisë nga Autoritetit Kontraktues.

- Neni 15, pika 4, germa “d”: Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas legjislacionit në fuqi: plotësuar. Modifikimi do të ketë një ndikim pozitiv për sa i përket qëndrueshmërisë së sistemit dhe të funizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

- Neni 15, pika 4, germa “e”: Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Rej Energy” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e nevojshme për të miratuar kërkesën.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI :

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 177, seria PV12K, për “Prodhimin e energjisë elektrike” nga HEC-et: “Cermenica 1”, “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”, me fuqi totale të instaluar 3,88 mw, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 120, datë 29.8.2012.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin, Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 33, datë 21.2.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“BESTA” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK “KUÇOVA
2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR
2 mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15, të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve

dhe Mbikëqyrjes me nr. 30/3 prot., datë 7.2.2020, mbi kërkesën e shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Kuçova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 26.6.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Besta” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Kuçova 2” me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar me shkresën nr. 32/32, datë 26.6.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Besta” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 394/1 prot., datë 3.7.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoj plotësimin e dokumentacionit të munguar i cili konsistonte në:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “P”, marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga Këshilli i Ministrave në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës;

- germa “g”, dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Dokumentacioni teknik për centralet solare.

- Neni 9, pika 4.4.1, të dhënat teknike për centralet solare.

- Neni 9, pika 4.4.2, të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin. Të dhënat teknike janë paraqitur si pjesë përbërëse e studimit të parafizibilitetit.

- Neni 9, pika 4.4.3, dokumentacioni teknik dhe grafik.

a) Paraqitje e përgjithshme skematike të centralit A1.



b) Një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohet qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes.

c) Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastre) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000:

d) Një hartë topografike ku të paraqitet qartë gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1:25000.

- Neni 9, pika 4.4.4, dokumentacioni teknik-ekonomik.

a) Studimi i fizibilitetit.

b) Grafiku i zbatimit të projektit.

c) Oponenca teknike e projektit.

- Neni 9, pika 4.4.5, leje nga institucione të tjera.

a) Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes.

b) Leje mjedisore nga organet përkatëse.

- ERE në datën 21.8.2019, organizoi një seancë dëgjimore (njoftimi i seancës dëgjimore, nr. 394/2 prot., datë 14.8.2019) me përfaqësues të shoqërisë “Besta” sh.p.k., në të cilën u diskutua mbi dokumentacionin e munguar dhe paqartësitë e krijuara në lidhje me të. Në këtë seancë shoqërisë i'u la detyrë që të përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar me shpjegimet e nevojshme për këtë aplikim.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën nr. 394/4 prot., datë 11.9.2019, shoqëria “Besta” sh.p.k. ka përcjellë në ERE në lidhje me dokumentacionin e munguar argumentet si më poshtë:

- Shoqëria deklaron se ka aplikuar në MIE në datën 14.6.2018 dhe është në pritje të miratimit të projektit fotovoltaiik 2 mw në Kuçovë.

- Sa i përket lejes mjedisore shoqëria “Besta” sh.p.k., bën me dije se është në pritje të miratimit të saj nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

- Sa i përket certifikatës së pronësisë, shoqëria bën me dije se është në pritje të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të Kuçovës për miratimin e kontratës së qirasë së tokës ku do të ndërtohet centrali fotovoltaiik dhe kujton se nga kjo Bashki ka marrë miratim paraprak për nënshkrimin e kontratës.

- Sa i përket miratimit të pikës së lidhjes me rrjetin e OSHEE sh.a., shoqëria “Besta” sh.p.k., bën me dije se disponon miratimin paraprak.

- Në vijim të sa më sipër, ERE me shkresën nr. 394/5 prot., datë 15.10.2019, iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me një kërkesë për informacion në lidhje me statusin e urdhrit të ministrit nr. 774, datë 5.11.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e kuadrit ligjor të rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike nga Dielli” dhe pajisjen e shoqërisë “Besta” sh.p.k., me miratim paraprak për centralin fotovoltaiik “Kuçova 2”.

- Në përgjigje të sa më sipër, MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 394/6, datë 8.11.2019 ka bërë me dije se: shoqëria “Besta” sh.p.k. ka paraqitur pranë MIE-s aplikimin për t'u pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit të ri prodhues të energjisë elektrike fotovoltaiike 2 mw, në datën 14.6.2018 dhe është pajisur nga MIE me miratimin paraprak “Për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike 2 mw dhe veprave ndihmëse në zonën Kuçovë, Bashkia Kuçovë, qarku Berat”.

- MIE bën me dije ERE-n se urdhri i ministrit nr. 774, datë 5.11.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e kuadrit ligjor të rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike nga Dielli”, është ende në fuqi.

- Në vijim të korrespondencës me MIE-n edhe vetë shoqëria “Besta” sh.p.k. ka përcjellë me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 394/7, datë 8.11.2019, miratimin paraprak të lëshuar nga MIE, por jo miratimin përfundimtar të MIE-s, për këtë projekt dhe kontratën e lidhur me këtë të fundit për burimin gjenerues fotovoltaiik prej 2 mw, në zonën e Kuçovës.

- ERE vlerëson se dokumentacioni i munguar është thelbësor për të çuar Bordin në një vendimmarrje për miratimin e kërkesës së aplikuesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Kuçova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 34, datë 21.2.2020

**MBI MODIFIKIMIN E ANEKSIT TË
LICENCËS SË SHOQËRISË “HEC-i
BISHNICA 1, 2” SHPK, NR. 95, SERIA
PV10K, DHËNË ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-
s NR. 23, DATË 23.3.2010, PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC-i
BISHNICA 1, 2” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a” dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 30/6 prot., datë, 12.2.2020, “Për modifikimin e licencës së shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., nr. 95, seria PV10K, dhënë me vendimin e Bordit të komisionarëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar”,

konstatoi se:

- Me shkresën protokolluar në ERE nr. 738 prot., datë 13.11.2019, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për modifikim licence.

- Shoqëria “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 95, seria PV10K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 14, datë 23.1.2020, filloi procedurën për modifikimin e licencës nr. 95, seria PV10K, dhënë shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, i cili konsistonte në ndryshimin e njërive gjeneruese:

- Numri i njërive gjeneruese:

Është: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 mw.

Bëhet: 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 mw.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 14, datë 23.1.2020, u krye njoftimi në medien e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në rregullore nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta.

- Me shkresën protokolluar në ERE me nr. 389/1 prot., datë 5.2.2020, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar. Shoqëria deklaron se shtimi i agregatit është vendosur për arsye të vështirësisë që ka hasur HEC-i në plotësimin e detyrimeve kontraktuale për prodhimin e energjisë elektrike.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: plotësuar. Me shkresën nr. 389/1 prot., datë 5.2.2020, shoqëria ka depozituar në ERE vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., të datës 5.2.2020, ku është vendosur të miratohet shtesa e një agregati të ri.

- Neni 15, pika 4, germa “c”: miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin



nga organe të tjera: plotësuar. Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e MIE-s nr. 10416/3 prot., datë 24.9.2018, në të cilën citohet se AKBN-ja e ka vlerësuar të pranueshëm vendosjen nga ana e shoqërisë të një agregati shtesë në hidrocentralin “Bishnica 2”, sipas kushteve të cituara në shkresën e AKBN-së nr. 6740/1 prot., datë 30.8.2019.

- Neni 15, pika 4, germa “d”: ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi: plotësuar. Shoqëria ka deklaruar se vendosja e këtij agregati shërben për të optimizuar skemën me qëllim realizimin e prodhimit të energjisë elektrike, siç parashikuar në kontratën e koncesionit dhe për të shfrytëzuar funksionimin e tij në rastin e periudhave me prurje të ulëta.

- Neni 15, pika 4, germa “e”: të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar. Rezulton se shoqëria nuk është debitore sa u përket pagesave të rregullimit në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e aneksit të licencës nr. 95, seria PV10K, të shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, me ndryshimin si më poshtë:

- Numri i njëjësive gjeneruese:

Ishte: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 mw.

Bëhet: 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej në ERE rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 37, datë 27.2.2020

MBI VENDIMIN E ERE-s NR. 10, DATË 20.1.2020, “MBI KËRKESËN PËR MOSLICENCIMIN E SHOQËRISË MP-HEC SHPK NGA ERE DHE KËRKESËN PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 187, DATË 25.11.2019, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 98, 107, 113, 117 dhe 144 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 16, pika 2, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.2.2020, pasi shqyrtoi relacionin nr. 36/3 prot., datë 25.2.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtorisë së Çështjeve Ligjore të ERE-s, “Mbi vendimin e ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, mbi kërkesën për moslicencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 20.1.2020, pasi ka shqyrtuar relacionin e përgatitur në lidhje me kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, ka marrë vendimin nr. 10, datë 20.1.2020.

- Për marrjen e këtij vendimi të ndërmjetëm, ERE mori shkas nga shkresa e kërkuarit, e protokolluar në ERE, me nr. 782/3, datë 19.12.2019, i cili në cilësinë e palës së interesuar, ka kërkuar rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”.



- Për shkak të kompleksitetit të çështjes në shqyrtim, nevojës për verifikime, të cilat konsistojnë në përpunimin e të dhënave dhe korrespondencën/komunikimin me institucionet të tjera, për shkak të kompetencës së ligjit, me vendimin nr. 10, datë 20.01.2020, u vendos zgjatja e afatit të shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit, me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar të mbështetur në prova, të verifikuara dhe konfirmuara nga organet kompetente.

- Ashtu sikurse konstatohet edhe në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, kërkesa e kërkuarit është paraqitur brenda afatit ligjor, në zbatim të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Kërkuari, në raport me ERE-n, është në cilësinë e palës së interesuar në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative, në kushtet kur një vendimmarrje e ERE-s mund ta cenojë interesin e tij të ligjshëm dhe jo si një i licencuar apo përfaqësues i një organi drejtues i një subjekti të licencuar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE njoftoi zyrtarisht palët e interesit në lidhje me këtë vendim të ndërmjetëm, si dhe iu drejtua organeve kompetente për verifikimin e pretendimeve dhe të provave të depozituara nga kërkuari dhe të atyre që ERE dispononte, në kuadër të një kërkesë për licencim.

- Në vijim, në ERE ka mbërritur kërkesa e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. me nr. 369/1 prot. i ERE-s, datë 6.2.2020, me anë të së cilës shoqëria kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, si akt i marrë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 16, pika 5, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Vendimi nr. 10, datë 20.1.2020, për shtyrjen e afatit, është një akt procedural, siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 130, të Kodit të Procedurës Administrative dhe nuk mund të ankimohej veçmas nga vendimi përfundimtar.

- Konstatohet se në zbatim të nenit 116 i Kodit të Procedurës Administrative nuk ndodhemi në kushtet e aktit absolutisht të pavlefshëm (vendimi nr. 10, datë 20.1.2020), sepse për marrjen e këtij vendimi është ndjekur me përpikëri procedura e përcaktuar në nenin e sipërcituar, sa i përket kompetencës së ERE-s për të marrë këtë vendim,

formës ose elementeve të tjera të detyrueshme të aktit administrativ.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 369/1 prot. të ERE-s, datë 6.2.2020, shoqëria MP-HEC sh.p.k. ka njoftuar ERE-n për ndryshimin e administratorit të saj.

- Ndodhur në rrethanat kur vendimi i ndërmjetëm i Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, lidhej me verifikimin e të dhënave që lidheshin me administratorin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k., me ndryshimin e administratorit të shoqërisë, konstatohet se ky shkak ligjor ka rënë.

- Në këto kushte, ERE, në zbatim të nenit 68, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, organi që ka nxjerrë vendimin e ndërmjetëm ka të drejtën të shfuqizojë vendimin e ndërmjetëm.

- Me shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm të Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, i marrë në rrethanat kur nga ERE u gjykua e nevojshme marrja e këtij vendimi për konstatimin e vërtetësisë dhe të legjitimitetit të pretendimeve të palës kërkuuese për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, bie dhe shkak ligjor për të cilin u mor ky vendim.

- Me konstatimin e rrethanave të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, në kushtet e nenit 130 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe konstatimin se nuk plotësohet asnjë nga rrethanat për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të këtij vendimi, kërkesa e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. adresohet në këtë vendimmarrje.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 10 /2020, “Mbi kërkesën për moslicencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë ‘MP-HEC’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Niçë’”.

2. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187/2019, për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”.



3. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë MP-HEC sh.p.k. për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 10/2020, “Mbi kërkesën për moslicencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë ‘MP-HEC’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Niçë’”.

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 39, datë 6.3.2020

MBI MIRATIMIN E AMENDIMIT TË KONTRATËS ME NR. KESH/NR. 6651 PROT., DHE OST/NR. 8859 PROT., DATË 31.12.2018, LIDHUR NDËRMJET OST SHA DHE KESH SHA, “PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË BALANCIMIT, KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE”

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; nenit 105, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Drejtorisë së Monitorimit të Tregut nr. 30/10 prot., datë 18.2.2020, në lidhje me miratimin e amendimit të kontratës me nr. KESH/6651 prot., dhe nr. OST/8859 prot., datë 31.12.2018, të lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 84, datë 31.5.2019,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 269/2 prot., datë 24.1.2020, protokolluar me tonën nr. 140 prot., datë 27.1.2020, ka përcjellë për miratim në ERE amendimin e kontratës me nr. KESH/ nr. 6651 prot., dhe OST/nr. 8859 prot., datë 31/12/2018, të lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”, kontratë e cila është miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 84, datë 31.5.2019.

- Sa më sipër, vjen si kërkesë e në zbatim të nenit 15 të kontratës së miratuar me vendimin nr. 84, datë 31.5.2019, të Bordit të ERE-s, ku citohet: “Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me një dokument të shkruar të firmosur nga të dyja palët dhe të miratuar nga ERE”.

- Kontrata bazë mbulon periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019, për sigurimin e shërbimit të balancimit midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Ky amendim vjen prej nevojës së palëve për të fituar kohë, me qëllim mbylljen e negociatave për nënshkrimin e kontratës së vitit 2020 në vijim, dhe njëkohësisht për kryerjen e disa testeve për implementimin e draftkontratës së ardhshme.

- Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të përbashkët kanë vendosur të amendojnë këtë kontratë duke ndryshuar kohëzgjatjen e kontratës, nëpërmjet shtrirjes së efekteve të saj deri në datën 31.1.2020.

- ERE, me shkresën nr. 142/1 prot., datë 4.2.2020, i ka bërë me dije OST sh.a., se ERE i shqyrton aktet bazuar në një procedurë të përcaktuar në rregulloren e brendshme të organizimit dhe të funksionimit të ERE-s, miratuar me vendim të Bordit nr. 144, datë 30.9.2019. Me të njëjtën shkresë, ERE ka kërkuar që palët në zbatim të detyrimeve ligjore, të hartojnë e dakordësojnë kontratën “Për sigurimin e shërbimit të balancimit” për vitin 2020 dhe ta paraqesin për shqyrtim në ERE duke respektuar afatet kohore.

- Amendimi i kontratës konsiston në ndryshimin e nenit 17, paragrafi i dytë, si më poshtë: “Kjo marrëveshje i shtrin efektet e saj nga data 1.1.2019 (data e fillimit) deri në datën 31.1.2020 (data e përfundimit)”.

- Mbështetur në nenin 105, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative “Efektet prapavepruese”, i cili parashikon: “organi kompetent mund t’i japë fuqi prapavepruese aktit



kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë”, ERE legjitimohet në marrjen e këtij vendimi.

- Duke qenë se palët me vullnetin e tyre kanë nënshkruar amendimin e kontratës, rezulton i plotësuar sa më sipër vendosur si kusht për parashikimin e efekteve prapavepruese në një akt të organit vendimmarrës.

- ERE konstaton se palët ende nuk kanë dakordësuar një marrëveshje për rregullimin e marrëdhënies mes tyre për vitin 2020.

- ERE konstaton se ndërkohë, OST sh.a. e siguron shërbimin e balancimit dhe të kapacitetit rezervë nga KESH sh.a.

- ERE vlerëson se ky rregullim duhet të vazhdojë përtej afatit të parashikuar në marrëveshjen për të cilën kërkohet miratimi i amendimit të kontratës, në kushtet që ky shërbim është i lidhur me sigurinë e furnizimit e aktualisht OST-ja nuk ka mundur të sigurojë nga burime të tjera këtë shërbim.

- KESH sh.a., i pranishëm në mbledhje, konfirmoi vijimin e ekzekutimit të këtij shërbimi për OST-në, përtej afateve të përcaktuar në kërkesën për amendim, si dhe dakordësinë dhe vullnetin e palëve lidhur me kërkesën e paraqitur në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Kontrata KESH/nr. 6651 prot., dhe OST/nr. 8859 prot., datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”, do të shtrijë efektet e përcaktuara në nenin 15, të saj, deri në miratimin nga ERE të kontratës “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese” për vitin 2020, të paraqitur nga palët në mungesë të burimeve të tjera të sigurimit të këtij shërbimi për OST sh.a.

2. Për periudhën deri në miratimin e kontratës “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, Kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese” për vitin 2020, nëse çmimi i energjisë së livruar dhe të marrë bazuar në kontratën në fuqi, ndryshon nga çmimi i dakordësuar mes palëve për vitin 2020,

faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 40, datë 6.3.2020

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO), SI DHE ROLET E PËRGJEGJËSITË E NEMO-s DHE OPERATORËVE TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË NË TREGUN E BASHKUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 57, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM-së nr. 322, datë 15.5.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut”, nenit 19, pika 1, germa “P” dhe nenit 26 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, nr. 36/2 prot., datë 24.2.2020, “Mbi miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësive të NEMO-s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendim nr. 240, datë 23.12.2019, vendosi fillimin e procedurës për



miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.

- Me shkresën nr. 32/62 prot., datë 31.12.2019, është publikuar njoftimi në shtypin e shkruar me qëllim marrjen e opinioneve dhe komenteve nga palët e interesuara.

- Me shkresën nr. 8 prot., datë 6.1.2020 drafti i Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar i është përcjellë dhe palëve të interesit për opinione.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar për marrjen e opinioneve dhe komenteve rezultoi se nuk ka komente ose opinione nga palët e interesit për këtë rregullore.

- Bazuar në urdhrin nr. 33, datë 28.1.2020, në datën 31.1.2020, u realizua një seancë dëgjimore në ERE me pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike. Në këtë seancë ishin ftuar për të marrë pjesë përfaqësues të OST sh.a., KESH sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe nga Autoriteti i Konkurrencës.

- Përfaqësuesit e KESH sh.a. dhe të OST sh.a. kërkuan në këtë seancë harmonizim të termave dhe përshtatje të tyre me aktet e tjera në fuqi. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë pasi ndikon në përmirësimin e terminologjisë së përdorur në rregullore dhe harmonizimin e saj me akte të tjera në fuqi. Element tjetër i propozuar në seancën dëgjimore ishte mundësia e implementimit të plotë të rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionave CACA (*capacity allocation and congestion management*).

- Në këtë kuadër ERE vlerëson si vijon: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka propozuar që në këtë rregullore të parashikohej edhe funksionimi i Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), siç është rekomanduar nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB), në mbledhjen e datës 24.4.2019, i cili ka mbështetur masat rregullatore për mbështetjen e implementimit të kushteve të Bashkimit të Tregjeve të ditës në

avancë në palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë. Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionave (*capacity allocation and congestion management*) (CACM) përcakton qartë se për të bërë të mundur funksionimin e Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë të sektorit të energjisë elektrike në vendet anëtare të Sekretariatit dhe Bashkimit Evropian, duhet të përcaktohen përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmetimit (OST) dhe operatorëve të tregut të ditës në avancë (NEMO).

- Në rastin e vendit tonë, duke marrë në konsideratë dhe sugjerimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe në vijim të procesit të hapur të konsultimit ku të vetmet komente janë ato të shprehura në seancën dëgjimore të datës 31.1.2020, është hartuar dhe përditësuar Rregullorja e Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar. (bashkëlidhur)

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 41, datë 6.3.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KROI MBRET ENERGJI” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et:
“BACKA 1”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1600 kw; HEC “BACKA 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000
kw; HEC “BACKA A”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 500 kw; HEC “BACKA
B”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 500
kw; HEC “BACKA C”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 720 kw, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 7320 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 28/5,1 prot., datë 25.2.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC ‘Backa 1’, me kapacitet të instaluar 1600 kw; HEC ‘Backa 2’, me kapacitet të instaluar 4000 kw; HEC ‘Backa A’, me kapacitet të instaluar 500 kw; HEC ‘Backa B’, me kapacitet të instaluar 500 kw; HEC ‘Backa C’, me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet totale të instaluara 7320 kw”,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 178, datë 14.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të vendimmarrjes, ERE, me shkresën nr. 32/51 prot., datë 18.11.2019, ka bërë publikimin në medien e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në

veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Backa 1”, me kapacitet të instaluar 1600 kw, HEC “Backa 2”, me kapacitet të instaluar 4000 kw, HEC “Backa A”, me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC “Backa B”, me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC “Backa C”, me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet totale të instaluara 7320 kw dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk ka pasur vërejtje apo komente nga palë të interesuara.

- Me shkresën nr. 643/3 prot., datë 20.11.2019 dhe nr. 643/6 prot., datë 11.12.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar, në përgjigje të së cilës me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 634/7 prot., datë 12.12.2019, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar në zbatim të nenit 8 të kontratës së koncesionit dhe është regjistruar në QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në datën 20.7.2012.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., ka paraqitur kontratën e koncesionit nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, të lidhur midis palëve: koncesionarit “Alba Konstruktion” sh.p.k. dhe METE-s, me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, “Për ndërtim-operimin dhe transferimin e hidrocentraleve ‘Backa 1’, ‘Backa 2’, ‘Backa A’, ‘Backa B’, ‘Backa C’”, me përfundimin e periudhës së përcaktuar në kontratën e koncesionit tek Autoriteti Kontraktues.

- Kontrata e koncesionit ka një kohëzgjatje prej 35 vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të saj. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 15 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullësor publik nr. 3487 prot., datë 20.11.2018, të lidhur midis palëve: Bashkia Skrapar, në cilësinë e qiradhënësit dhe sShoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në cilësinë e Qiramarrësit, për një afat njëvjeçar, e cili fillon nga dita e nesërme e nënshkrimit të saj. Gjithashtu, ka paraqitur në ERE kontratën e rinovuar të qirasë, me numër 4297 prot., datë 10.12.2019, për një afat njëvjeçar, me të



drejtë rinovimi, duke filluar nga e nesërmja e nënshkrimit të kësaj kontrate.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., me shkresën nr. 5612 prot., datë 28.3.2017, i është drejtuar OSHEE sh.a., me kërkesën për miratim e pikës së lidhjes së kaskadës së HEC-ve: “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”.

- Referuar kërkesës sa sipër cituar, OSHEE sh.a., me shkresën nr. 812/5 prot., datë 25.4.2018, drejtuar shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., i konfirmon “Miratimin e pikës së lidhjes të HEC-ve: “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”, e cila do të lidhet në rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 10 kV, të Nënstacionit 35/10 kV Çorovodë e Re. Lidhja e kaskadës së HEC-ve: “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”, me linjën 35 kV, në zbarat 10 kV, do të realizohet nëpërmjet një transformatori zbritës 35/10 kV që do të vendoset pranë Nënstacionit Çorovodë e Re.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin e lëshuar nga Agjencia e Ujit, të Basenit Seman, nr. 442 prot., datë 9.11.2011, për pajisjen me lejen e ujit, të shoqërisë “Alba Konstruktion” sh.p.k. Gjithashtu, me shkresën nr. 634/7, datë 13.2.2019 (plotësim dokumentacioni), ajo ka depozituar në ERE vendimin nr. 16, datë 15.9.2010, të lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman “Për miratimin në parim të kërkesës, për përdorimin e rezervave ujore me koncesion, për prodhim hidroenergjie në H/C, nga përroi i Straveckës në Skrapar”. ERE, me shkresën nr. 634/8 prot., datë 20.12.2019, i është drejtuar Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Seman, lidhur me rikonfirmimin ose ndryshimin e vendimit nr.16, datë 15.9.2010, “Për miratimin në parim të kërkesës, për përdorimin e rezervave ujore me koncesion, për prodhim hidroenergjie në H/C, nga përroi i Straveckës në Skrapar”.

- Me shkresën protokolluar në ERE me nr. 34/2 prot., datë 23.1.2020, shoqëria ka depozituar në ERE aplikimin e bërë pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Seman, “Aplikim për pajisje me leje të përdorimit ujqor”, protokolluar nga kjo e fundit me nr. 172 prot., datë 22.1.2020.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE deklaratën mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, shkresë nr. 15 prot., datë 23.2.2015, me nr. 77 identifikim dhe nr. 8 vendimi, për personin juridik “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., “Për të

zhvilluar projektin kaskadë hidroenergetike Backe-Storoveckë (HEC A, HEC C, HEC B, HEC 1, HEC 2), Komuna Potom dhe Qendër, rrethi Skrapar, qarku Berat. Kjo deklaratë është e vlefshme pasi veprimtaria të licencohet nga institucionet e tjera. Mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe dyvjeçare, sjell për pasojë pavlefshmërinë e deklaratës për ushtrim e këtij aktiviteti. Aktualisht rezulton sipas deklarimeve se vepra ka përfunduar së ndërtuari.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar pjesërisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, plotësuar

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”, plotësuar pjesërisht.

Mungon dokumentacioni i plotë, i kërkuar sipas germës “b” (Leja përdorimit të ujit). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor përpara fillimit të operimit të veprimtarisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kw; “Backa 2”, me kapacitet të instaluar 4000 kw, “Backa A”, me kapacitet të instaluar 500 kw; “Backa B”, me kapacitet të instaluar 500 kw dhe “Backa C”, me kapacitet të instaluar 720 kV, me kapacitet totale 7320 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të



depozitohet në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor.

2. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 42, datë 6.3.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“ELECTRAL BATRA HPP” SHPK, PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “SELITA”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1798 kw;
HEC “FRANKTHI”, 2129 kw DHE HEC
“BATRA”, 2411 kw, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 6338 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 30/11 prot., datë 21.2.2020, mbi licencimin e shoqërisë “Electral Batra HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 135, datë 6.9.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Electral Batra HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar me shkresën nr. 32/41, datë 6.9.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Electral Batra HPP” sh.p.k.

- Në vijim, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresat nr. 510/1 prot., datë 11.9.2019, dhe 510/4 prot., datë 13.11.2019, me anë të të cilave i bëri me dije fillimin e procedurës dhe i drejtoi kërkesat për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Electral Batra HPP” sh.p.k., me shkresat e protokolluar në ERE me nr. 510/3, datë 21.10.2019, nr. 23 prot., datë 9.1.2020, dhe nr. 135 prot. i ERE-s, datë 24.1.2020, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Electral Batra HPP” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8 të Kontratës Koncesionare të formës BOT, me nr. 3393 rep. dhe nr. 1231 kol., datë 20.12.2016, “Për ndërtimin e HEC-eve ‘Batra’ nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3”, të lidhur ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të shoqërisë “Electral” sh.p.k. me “ALBAVIA” sh.p.k. në cilësinë e Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (sot “MIE”), në zbatim të VKM-së nr. 623, datë 7.9.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe dhënien me koncesion të HEC-eve ‘Batra’ nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”. Kjo shoqëri, është regjistruar në QKB, në datën 23.12.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE edhe kontratën shtesë të koncesionit me nr. 813 rep., nr. 273 kol., datë 6.9.2017, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin e HEC-eve ‘Batra’ nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3”.

- Shoqëria “Electral Batra HPP” sh.p.k. ka depozituar në ERE certifikatat për vërtetim titulli



“Në përdorim”, për pronësitë ku do të shtrihet projekti i HEC-eve në zonat kadastrale me nr. 1325 dhe nr. 1626, të rrethit Mat, të lëshuara nga ZVRPP Mat për shoqërinë “Electral” dhe shoqërinë “Albavia”, në cilësinë e aksionarëve të shoqërisë koncesionare “Electral Batra HPP” sh.p.k. dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive që kanë lidhur kontratën e koncesionit me MIE. Këto certifikata janë të shoqëruara me hartën treguese të regjistrimit dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme nga të cilat rezulton se prona që jepet në përdorim është në pronësi të shtetit.

- Shoqëria ka depozituar në ERE, Oponencën Teknike të kryer nga AKBN-ja nr. 1789/1 prot., datë 13.6.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC-eve “Selitë”, “Frankth” dhe “Batra”. Grupi i Oponencës Teknike ka konkluduar se projekti i zbatimit për kaskadën e HEC-eve “Batra”, “Frankth” dhe “Selitë”, plotëson kushtet teknike dhe standardet e projektimit për fazën e ndërtimit të veprës hidroenergetike.

- Shoqëria ka depozituar në ERE deklaratën mjedisore me nr. 10827/1 prot., datë 19.12.2019, me nr. identifikimi 1171 dhe nr. vendimi 65. Kjo deklaratë mjedisore lëshohet për shoqërinë “Electral Batra HPP” sh.p.k., për “Ndërtimin e hidrocentraleve ‘Batër’, ‘Frankth’, ‘Selitë’”, me vendndodhje në pellgun e Përroit të Zallit të Batrës, Bashkia Mat, qarku Dibër, për kapacitetin e instaluar 6338 kw. Sa i përket afatit kohor të vlefshmërisë së deklaratës mjedisore shprehet se: “Nëse veprimtaria nuk fillon zbatimin në terren brenda dy viteve nga data e miratimit të vendimit për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para”.

- Për gjithë sa më sipër, konkludojmë se rezultojnë të paplotësuara apo plotësuar pjesërisht dokumentet, si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik për HEC.

- Neni 9, pika 4.1.1, të dhëna specifike për HEC.

- Neni 9, pika 4.1.2, të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin

- Sipas nenit 10 “Programi i punimeve” të kontratës së koncesionit, koncesionari merr përsipër të fillojë punimet në zbatim të projektit brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit. Koncesionari merr përsipër të vërë në

punë HEC-in brenda 12 muajve nga data e marrjes së lejes së ndërtimit.

- Për HEC “Selita”, HEC “Batra” dhe HEC “Frankth”: për çdo njërën prej tyre mungojnë ende të dhënat për tensionin në dalje të gjeneratorit; n/st. ku lidhet; tensioni i rrjetit të shpërndarjes /transmetimit ku lidhet centrali; rendimenti; pengesë për plotësimin e këtij kushti është bërë refuzimi i OST sh.a., për lidhjen me rrjetin e transmetimit, pavarësisht se ERE ka pasur një sërë komunikimesh me OST sh.a., së fundmi me shkresën nr. 589/4 prot., datë 15.11.2019, sa i përket problematikës së pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit. OST sh.a., me shkresën e tij të fundit nr. 589/5 prot., datë 23.12.2019, vijon të mbajë të njëjtin qëndrim duke sugjeruar një zgjidhje alternative, për lidhjen e shoqërisë “Electral Batra HPP” sh.p.k., në nënstacionin e një shoqërie private, i cili nuk është në pronësi të OST sh.a. Në nenin 29, të ligjit nr. 43/3015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar parashikohet se “Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes garantojnë aksesin në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifat e miratuara dhe të publikuara nga ERE. Prodhuesit, që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike”. Sa më sipër, rezulton se për kushtet që lidhen me të dhënat e gjeneruara pas miratimit të pikës së lidhjes, përmbushjen e së cilës e garanton ligji dhe e mundësojnë operatorët përgjegjës të sistemit, aplikuesi ka marrë të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e tyre.

- Dokumentacioni teknik-ekonomik.

- Neni 9, pika 4.1.4, germa “a”: studimi i fizibilitetit. Në ERE nuk është depozituar një kopje e studimit të fizibilitetit të cilin shoqëria ka depozituar në MIE para marrjes së miratimit dhe nënshkrimit të kontratës së koncesionit me Autoritetin Shtetëror.

- Leje nga institucione të tjera.

- Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes. Rezulton se për kushtin që lidhet me miratimin e pikës së lidhjes, përmbushjen e së cilës e garanton ligji dhe e mundësojnë operatorët përgjegjës të sistemit, aplikuesi ka marrë të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e tyre, dhe



mbështetur në nenin 29, të ligjit nr. 43/3015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, janë operatorët e sistemit përgjegjës për garantimin e aksesit.

- Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike: pa plotësuar.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Electral Batra HPP” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar pjesërisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar pjesërisht.

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Electral Batra HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Selita” me kapacitet të instaluar 1798 kw, HEC “Frankthi” 2129 kw dhe HEC “Batra” 2411 kw, me kapacitet total të instaluar 6338 kw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE:

- Miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin elektroenergetik.

- Dokumentacioni teknik për HEC-et.

- Lejen e shfrytëzimit të ujit.

- Studimin e fizibilitetit.

2. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet

ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 43, datë 6.3.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA, PËR SHTYRJE TË AFATIT TË VENDIMMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; 53, pikat 1 dhe 3, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 24, pika 1, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 37/2 prot., datë 26.2.2020, mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 32/55 prot., datë 25.11.2019, ka kryer njoftimin në medien e shkruar, si dhe me shkresën nr. 729/1 prot., datë 3.12.2019, ka përcjellë pranë subjektit “Albgaz” sh.a., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar në dosjen e aplikimit.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 84 prot., datë 16.1.2019, ERE i është drejtuar sërish shoqërisë me një kujtesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 288 prot., datë 28.1.2020, ka paraqitur pjesërisht dokumentacionin lidhur me plotësimin e kërkuar dhe plotësimi konsiston në vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të



Tatimeve Tiranë, me nr. T01704822, datë 14.1.2020, nga i cili rezulton se shoqëria nuk ka detyrim tatimor të papaguar deri në datën e lëshimit të vërtetimit. Për këtë arsye, ERE iu drejtua sërish shoqërisë “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 288/1 prot., datë 4.2.2020, duke i rikërkuar plotësimin sipas kërkesave të rregullores të dokumentacionit të mbetur.

- Në vijim, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 288/2 prot., datë 8.2.2020, ka përcjellë në ERE kërkesën për shtyrje të vendimmarrjes finale të Bordit, në pamundësi për t'i plotësuar këto dokumente brenda afateve dhe ka deklaruar se një pjesë e tyre është në proces përpilimi.

- Neni 24 i rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s parashikon se: Nëse një person paraqet një kërkesë të ndryshme nga sa parashikohet në këto rregulla, atëherë ERE do të procedojë në përputhje me dispozitat që rregullojnë atë çështje sipas legjislacionit në fuqi.

- Në zbatim të nenit 53, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.

- Afati i parashikuar në rregulloren e licencimit për marrjen e vendimit përfundimtar të Bordit të ERE për miratimin apo refuzimin e kërkesës është 60 ditë.

- Në zbatim të nenit 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Në zbatim të nenit 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit

të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar, sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”.

Kërkuesi, ka paraqitur një kërkesë të arsyetuar, përpara përmbushjes së afateve të parashikuara për mbylljen e kësaj procedure në datën 3.3.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 1.7.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 1160, datë 12.12.2019, vendosi të shpallë të zhdukur shtetasin Aldo Çavollo, i datëlindjes 22.3.1966, si dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij, shtetasen Rubije Çavolli.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2020-388) 119, datë 24.1.2020, vendosi të shpallë të zhdukur shtetasin Dhimitër Malja, i datëlindjes 15.9.1962.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë